



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr.17, datë 28.05.2020

**Për miratimin e raportit mbi realizimin e buxhetit  
të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave  
për tremujorin e parë të mbyllur në 31 Mars 2020**

Në mbështetje të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, nenit 62, pika 1 të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “d”, të nenit 7, pika 6, dhe nenit 8, pika 2, shkronja “m” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin mbi realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për tremujorin parë të mbyllur në 31 Mars 2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**